



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE  
DEGA E DOGANËS VLORË

Nr. 3722 Prot.

Vlorë, më 17/12/2024

**Lënda :** *Kërkesë për Shpallje Publike të aktit administrativ (Vendimet e Sekuestros)*

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË DOGANAVE

DEPARTAMENTIT ADMINISTRATIV

• Drejtoria së Burimeve Mbështetëse



Në respektim të Ligjit Nr.102, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, nenit 162 të Ligjit Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Udhëzimit Nr.15, datë 03.12.2018 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë, “Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës”, kërkojmë nga ana Juaj shpalljen publike të tre akteve administrativ – Vendimet e Sekuestros si vijon :

- Nr.3704 Prot., datë 16/12/2024, i materializuar për subjektin “Neritan Llanaj” p.f, me banim në Vlorë.
- Nr.3705 Prot., datë 16/12/2024, i materializuar për subjektin “MAGS SHOES” sh.p.k, me NUIS L66412202O, me seli në Vlorë (Lagjja “Rilindja”, Rruga “Riza Salati”, godinë 4 katëshe).
- Nr.3706 Prot., datë 16/12/2024, i materializuar për subjektin “BIG BLU POOL & SPA” sh.p.k, me NUIS L91408025N, me seli në Tiranë (Kashar, Autostrada Durrës -Tiranë, Zona Kadastrale 21/05).

Jemi në pritje të konfirmimit nga ana Juaj për datën e shpalljes publike. Bashkëngjitur, gjeni kopje origjinale të tre akteve të lartcituara - gjithsej 3 (tre) fletë.

*Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,*





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE  
DEGA E DOGANËS VLORË

Nr. 3704.....Prot.

Vlorë, më 16/12/2024

**VENDIM SEKUESTRO**

**“Për rikuperimin me forcë të detyrimit doganor që debitori - subjekti “Neritan Llanaj” me ID I40425019A, me banim në Vlorë, ka ndaj Degës së Doganës Vlorë”.**

Dega e Doganës Vlorë, me Vendimin e saj Nr.72, me Nr.1206/1 Prot., datë 21/05/2024, ka vendosur kontabilizimin e detyrimit doganor në shumën 20,541 (Njëzetëmijë e pesëqind e dyzetentjë) lekë, për deklaratën doganore IM.4 me numër R 4897, datë 11/04/2024, ndaj subjektit debitor “Neritan Llanaj” p.f me NID I40425019A, me banim në Vlorë.

Ky Vendim i është njoftuar subjektit debitor “Neritan Llanaj” p.f me NID I40425019A, me anë të shërbimit postar, si dhe me anë të lajmërimit publik.

Personi juridik debitor “Neritan Llanaj” p.f me NID I40425019A, i njoftuar, nuk është paraqitur për të paguar vullnetarisht detyrimet e përcaktuara në Vendimin Nr. 72, me Nr.1206/1 Prot., datë 21/05/2024, si dhe nuk ka ushtruar ankim administrativ pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave në Tiranë, në zbatim të nenit 282 të Kodit Doganor.

Në këto kushte, në zbatim të Vendimit Nr. 72, me Nr.1206/1 Prot., datë 21/05/2024, me qëllim marrjen e masave përkatëse për rikuperimin me forcë të detyrimeve doganore, që Debitori - subjekti “Neritan Llanaj” p.f me NID I40425019A, ka ndaj Degës Doganore Vlorë, bazuar në nenin 280 të Kodit Doganor, nenin 511 e vijues të Kodit të Procedurës Civile si dhe Udhëzimin Nr.15, datë 03.12.2018 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë, “*Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës*”,

**V E N D O S A :**

- Të sekuestrohen vlerat monetare, kreditë, sendet me vlerë të çmuar, dokumentat me anë të të cilave bëhet pagesa, valutë e huaj e depozituar në bankë, që i përkasin debitorit, personit juridik - “Neritan Llanaj” p.f me NID I40425019A, apo garantuesve, që kanë detyrime ndaj debitorit.

- Të sekuestrohen mallrat, pasuritë e tundshme ose të patundshme, që i përkasin debitorit, personit juridik - “Neritan Llanaj” p.f me NID I40425019A, apo garantuesit/garantuesve që kanë detyrime ndaj debitorit.
- Sekuestrimi i mësipërm të kryhet deri në masën, që të bëhet i mundur plotësimi i detyrimeve që debitori, personi juridik “Neritan Llanaj” p.f me NID I40425019A, i ka Degës së Doganës Vlorë, në shumën totale 20,541 (Njëzetëmijë e pesëqind e dyzetënjë) lekë, sipas aktit administrativ - Vendimit të kontabilizimit të detyrimit doganor Nr.72, me Nr.1206/1 Prot., datë 21/05/2024, të Degës së Doganës Vlorë.

**KRYETAR**

**Artan Bedinaj**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE  
DEGA E DOGANËS VLORË

Nr. 3705 .....Prot.

Vlorë, më 16/12/2024

**VENDIM SEKUESTRO**

**“Për rikuperimin me forcë të detyrimit doganor që debitori - subjekti “MAGS SHOES” sh.p.k, me NUIS L66412202O, me seli në Vlorë, ka ndaj Degës së Doganës Vlorë”.**

Dega e Doganës Vlorë, me Vendimin e saj Nr.124, me Nr.2470/2 Prot., datë 09/09/2024, ka vendosur kontabilizimin e penalitetit doganor në shumën 20,000 (Njëzetëmijë) lekë, në zbatim të nenit 259/1/b të Kodit Doganor, ndaj subjektit debitor “MAGS SHOES” sh.p.k, me NUIS L66412202O, me seli në Vlorë (Lagjja “Rilindja”, Rruga “Riza Salati”, godinë 4 katëshe).

Ky Vendim i është njoftuar subjektit debitor “MAGS SHOES” sh.p.k, me NUIS L66412202O, me anë të shërbimit postar, si dhe me anë të lajmërimit publik.

Personi juridik debitor “MAGS SHOES” sh.p.k, me NUIS L66412202O, i njoftuar, nuk është paraqitur për të paguar vullnetarisht detyrimet e përcaktuara në Vendimin Nr. 124, me Nr.2470/2 Prot., datë 09/09/2024, si dhe nuk ka ushtruar ankim administrativ pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave në Tiranë, në zbatim të nenit 282 të Kodit Doganor.

Në këto kushte, në zbatim të Vendimit Nr.124, me Nr.2470/2 Prot., datë 09/09/2024, me qëllim marrjen e masave përkatëse për rikuperimin me forcë të detyrimeve doganore, që Debitori - subjekti “MAGS SHOES” sh.p.k, me NUIS L66412202O, ka ndaj Degës Doganore Vlorë, bazuar në nenin 280 të Kodit Doganor, nenin 511 e vijues të Kodit të Procedurës Civile si dhe Udhëzimin Nr.15, datë 03.12.2018 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë, “*Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës*”,

**V E N D O S A :**

- Të sekuestrohen vlerat monetare, kreditë, sendet me vlerë të çmuar, dokumentat me anë të të cilave bëhet pagesa, valutë e huaj e depozituar në bankë, që i përkasin debitorit, personit juridik - “MAGS SHOES” sh.p.k, me NUIS L66412202O, apo garantuesve, që kanë detyrime ndaj debitorit.

- Të sekuestrohen mallrat, pasuritë e tundshme ose të patundshme, që i përkasin debitorit, personit juridik - "MAGS SHOES" sh.p.k, me NUIS L664122020, apo garantuesit/garantuesve që kanë detyrime ndaj debitorit.
- Sekuestrimi i mësipërm të kryhet deri në masën, që të bëhet i mundur plotësimi i detyrimeve që debitori, personi juridik "MAGS SHOES" sh.p.k, me NUIS L664122020, i ka Degës së Doganës Vlorë, në shumën totale 20.000 (Njëzetëmijë) lekë, sipas aktit administrativ - Vendimit të kontabilizimit të detyrimit doganor Nr.124, me Nr.2470/2 Prot., datë 09/09/2024, të Degës së Doganës Vlorë.

**KRYETAR**

**Artan Bedinaj**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE  
DEGA E DOGANËS VLORË

Nr. 3706.....Prot.

Vlorë, më 16/12/2024

**VENDIM SEKUESTRO**

**“Për rikuperimin me forcë të detyrimit doganor që debitori - subjekti “BIG BLU POOL & SPA” sh.p.k, me NUIS L91408025N, me seli në Tiranë, ka ndaj Degës së Doganës Vlorë”.**

Dega e Doganës Vlorë, me Vendimin e saj Nr.127, me Nr.2724/1 Prot., datë 12/09/2024, ka vendosur kontabilizimin e detyrimit doganor në shumën 20,641 (Njëzetëmijë e gjashtëqind e dyzetënjë) lekë, për keqklasifikim të kodit tarifor në artikullin nr.2 të deklaratës doganore IMP. 4 - R 10876 dt 01/08/2022, si dhe penalizimin në masën e njëfishit të detyrimit doganor të papaguar, në shumën 20,641 (Njëzetëmijë e gjashtëqind e dyzetënjë) lekë, bazuar në nenin 256/1/a të Kodit Doganor, ndaj subjektit debitor “BIG BLU POOL & SPA” sh.p.k, me NUIS L91408025N, me seli në Tiranë (Kashar, Autostrada Durrës -Tiranë, Zona Kadastrale 21/05, Nr.Pas 1186/14, Nr.tel 068 2012345).

Ky Vendim i është njoftuar subjektit debitor “BIG BLU POOL & SPA” sh.p.k, me NUIS L91408025N, me anë të shërbimit postar, njoftimit elektronik, si dhe me anë të lajmërimit publik.

Personi juridik debitor “BIG BLU POOL & SPA” sh.p.k, me NUIS L91408025N, i njoftuar, nuk është paraqitur për të paguar vullnetarisht detyrimet e përcaktuara në Vendimin Nr.127, me Nr.2724/1 Prot., datë 12/09/2024, si dhe nuk ka ushtruar ankim administrativ pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave në Tiranë, në zbatim të nenit 282 të Kodit Doganor.

Në këto kushte, në zbatim të Vendimit Nr.127, me Nr.2724/1 Prot., datë 12/09/2024, me qëllim marrjen e masave përkatëse për rikuperimin me forcë të detyrimeve doganore, që Debitori - subjekti “BIG BLU POOL & SPA” sh.p.k, me NUIS L91408025N, ka ndaj Degës Doganore Vlorë, bazuar në nenin 280 të Kodit Doganor, nenin 511 e vijues të Kodit të Procedurës Civile si dhe Udhëzimin Nr.15, datë 03.12.2018 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë, “*Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës*”,

## V E N D O S A :

- Të sekuestrohen vlerat monetare, kreditë, sendet me vlerë të çmuar, dokumentat me anë të të cilave bëhet pagesa, valutë e huaj e depozituar në bankë, që i përkasin debitorit, personit juridik - "BIG BLU POOL & SPA" sh.p.k, me NUIS L91408025N, apo garantuesve, që kanë detyrime ndaj debitorit.
- Të sekuestrohen mallrat, pasuritë e tundshme ose të patundshme, që i përkasin debitorit, personit juridik - "BIG BLU POOL & SPA" sh.p.k, me NUIS L91408025N, apo garantuesit/garantuesve që kanë detyrime ndaj debitorit.
- Sekuestrimi i mësipërm të kryhet deri në masën, që të bëhet i mundur plotësimi i detyrimeve që debitori, personi juridik "BIG BLU POOL & SPA" sh.p.k, me NUIS L91408025N, i ka Degës së Doganës Vlorë, në shumën totale 41,282 (Dyzet e njëmijë e dyqind e tetëdhjet e dy) lekë, sipas aktit administrativ - Vendimit të kontabilizimit të detyrimit doganor Nr.127, me Nr.2724/1 Prot., datë 12/09/2024, të Degës së Doganës Vlorë.

**KRYETAR**

**Artan Bedinaj**

